# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

### V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 98, 99, 100 dhe 101 të Qeverisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Investimet e Huaja.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Produktet e Ndërtimit.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2012, mori:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu.

2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 06/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Pagesën e Pagave dhe Shtesave të Kryetrarëve/Kryesueseve dhe anëtarëve të Bordit për Rishqyrtimi n e Ankesave, Komiteteve të Auditimit, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar.

2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Integrimit Evropian.

2. Obligohet Ministria e Integrimit Evropiane dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr 03/L-175 për Borxhet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Vjetore e Borxhit për vitin 2013.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

# V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet dhe vlerësimet me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N9 Fushë Kosovë-Arllat-Gjurgjicë, Zonat Kadastrale Arllat dhe Llapushnik, Komuna Drenas, sipas tabelave të bashkangjitur këtij vendimi.

2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit , në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka

një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i detyruar të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.

7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi iu dërgohet :

-Zëvendëskryeministrave
-të gjitha ministrive(ministrave)
-Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-se
-Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2012, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për reduktimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2012 në shumë prej € 4,508,825 nga:

1.1 Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nga ndarjet buxhetore kursen € 1,519,628 si në vijim:

1.1.1. €480,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin e Administratës Qendrore, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga këto projekte : projekti " Ndërtimi i Objektit shkollor në Novo Sellë, Pejë" me kod 12352, ne vlerë prej €180,000: projekti "Instituti i Historisë- Biblioteka Kombëtare" me kod 06101, në vlerë prej €100,000, projekti "Ndërtimi i Shkollës Fillore në Fushë Kosovë" me kod 11031, në vlerë prej €100,000, projekti "Ndërtimi i Shkollës së mesme në Kaçanik" me kod 12353, në vlerë prej €100,000.

1.1.2. €1,039,628 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Universiteti i Prizrenit nga këto kategori ekonomike: €267,628 nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, €30,000 nga kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale, €742,000 nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Ngritja e Infrastrukturës se re dhe renovimi i objektit ekzistues për Universitetin e Prizrenit" me kod 12533.

1.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nga ndarjet buxhetore kursen € 300,000 si në vijim:

1.2.1 €200,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Pensionet Kontribut dhënës, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve,

1.2.2 €100,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Skema e Asistencës Sociale, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve.

1.3 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nga ndarjet buxhetore kursen €500,000 si në vijim:

1.3.1 € 500,000, reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin e Agjencionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, kategoria ekonomike shpenzime kapitale nga projekti "Ndërtimi i Zonave ekonomike nëpër Kosovë", me kod 12664,

1.4 Ministria e Punëve të Brendshme nga ndarjet buxhetore kursen €799,336 si në vijim

1.4.1. €150,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Shërbimet e Regjistrimit Civil, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Krijimi i Arkivës Elektronike" me kod 12201,
1.4.2. €628,528 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve dhe patentë shoferëve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Ndërtimet dhe Renovimet e QKRA-ve dhe Shtimet Operative-Vushtrri,Skenderaj,Deçan" me kod 12815,
1.4.3. €20,808 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Agjencioni i menaxhimit te emergjencave, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Ndërtimi i Objektit të AME-së" me kod 13162,

1.5. Universiteti i Prishtinës, nga ndarjet buxhetore kursen €1,389,861

1.5.1. €1,389,861 reduktim i ndarjes buxhetore nga nen programi Universiteti, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga këto projekte: projekti "Laboratori për Universitetin e Prishtinës" me kod 12295, në vlerë prej 119,381, projekti "Ndërtimi dhe projektimi i dy Fakulteteve në Mitrovice" me kod 13216, në vlerë prej €900,000, projekti "Projekti dhe ndërtimi i Fakultetit të Bujqësisë" me kod 13219, në vlerë prej € 70,480, projekti "Ndërtimi i Amfiteatrit për Fakultetin Ekonomik" me kod 13268, në vlerë prej € 250,000, projekti "Objekti i ri i Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë" me kod 13393, në vlerë prej € 50,000.

2. Aprovohet kërkesa buxhetore për mjete shtesë për këto Organizata Buxhetore në shumë prej €4,508,825:

2.1. Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i ndahen mjete shtesë në shumë prej €3,768,825 si në vijim:

2.1.1. €3,768,825 ndarje buxhetore për nën-programin -Administrata qendrore, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale për projektin" Blerja e librave" me kod 10144

2.2 Për Komunat e Republikës së Kosovës ndahen €740,000 sipas kësaj renditje:

-€330,000 në Komunën e Parteshit,
-€250,000 në Komunën e Klinës,
-€20,000 në Komunën e Vushtrrisë,

-€100,000 në Komunën e Gllogocit,
-€40,000 në Komunën e Mamushës.

3. Obligohen Kuvendet Komunale që pas nxjerrjes së këtij vendimi brenda 3 ditësh të njoftojnë Ministrinë e Financave-Departamentin e Buxhetit Komunal për nën-programet dhe kategoritë se ku do të ndahen mjetet.

4. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për harmonizime brenda organizatave buxhetore, si në vijim:

4.1 Ministria e Infrastrukturës

4.1.1. €3,498,294 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi -Ndërtimet e Reja të Rrugëve, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale konkretisht nga këto projekte: projekti-"Ndërtimi i rrugës StanTerg-Melenicë-Vllahi" me kod 10955, në vlerë prej €406,798, projekti "Rekonstruimi i Rrugës Regjionale R-125 Orllanë-Bervenikë-Kufi me Serbinë" me kod 13396, në vlerë prej €480,000; projekti "Asfaltimi i rrugës Raushiq-Turjak", me kod 13407, në vlerë prej €100,000; projekti "Asfaltimi i Rrugës Pogragjë-Llovcë" me kod 13397, në vlerë prej €140,000; projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Peqan i madh-Peqan i vogel" me kod 13398, në vlerë prej €145,000; projekti "Ndërtimi i rrugës Vojtesh-Ljubovec-Galice" me kod 10953, në vlerë prej €8,000; projekti "Ndërtimi i rrugës tranzitore në Shtime, faza e 2-te" me kod 12893, në vlerë prej €133,342; projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Qubrel" me kod 12896, në vlerë prej €115,154; projekti "Ndërtimi i rreth rrotullimit ne Veternik-Hyrja ne Prishtinë" me kod 13392, në vlerë prej €1,700,000; projekti" Asfaltimi i Rrugës Ferizaj-Nerodime" me kod 13405, në vlerë prej €180,000; projekti " Asfaltimi i rrugës në fshatin Poliqke- Kamenice" me kod 13399, në vlerë prej €90,000.

4.1.2. €1,442,914 barten në nën-programin e Mirëmbajtjes së Rrugëve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, për projektin "Mirëmbajtja Investive e Rrugëve me kod 13004,
4.1.3. €637,847 barten në nën-programin e Ndërtimeve të Urave, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, për këto projekte: projektin "Mirëmbajtja e Urave", me kod 10032, në vlerë prej €50,000 dhe projektin "Ndërtimi i rreth rrotullimit te stacioni i autobusëve" me kod 10720 në vlerë prej €587,847,
4.1.4. €1,417,533 barten në nën-programin e Rehabilitimit të Rrugëve për këto projekte: projektin "Rehabilitimi i rrugës Magjistrale M9 Prishtine-Peje" me kod 10034, në vlerë prej €1,280,000, projektin "Rehabilitimi i rrugës Batllave-Orllan" me kod 13257, në vlerë prej €137,533.

4.1.5 € 265,787 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Bashkëfinancimi me Kuvende Komunale, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Ndërtimi i rrugës ne fshatin Majanc-Lupç i Epërm-Popovë, KK Podujevë" me kod 13008. Mjetet rialokohen në projektin "Rikonstruimi i rrugës Gorance-Hani i Elezit" me kod 11587.

4.2 Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale

4.2.1 €750,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e Parakohshme të TMK-së nga kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe transfereve, këto mjete të

transferohen në nën-programin Pensionet për Invalidët e Luftës, kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve,

4.2.2 €300,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, nga kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe transfereve, këto mjete të transferohen në nën-programin Pensionet për Invalidët e Luftës, kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve,

4.2.3 €300,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së nga kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe transfereve, këto mjete të transferohen në këto nën programe:

4.2.4 €200,000 barten në nën-programin Institucionet, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve,

4.2.5 €50,000 barten në nën-programin Administrata Qendrore, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve ,

4.2.6 €50,000 barten në nën-programin Trajnimi Profesional, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.

4.3 Agjencioni Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale

4.3.1 €15,178 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi - Agjencioni Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale , nga projekti "Blerja e Veturave" me kod 13253, këto mjete transferohen në të njëjtin nën-program në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve.

4.4 Ministria e Punëve të Jashtme

4.4.1. €233,959 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi i Administratës Qendrore nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Pajisje Teknologjike" me kod 11075, këto mjete transferohen në nën-programin Ambasada, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve,

4.4.2. €235,716 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Ambasada nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Pajisje të Teknologjisë Informative" me kod 12253, këto mjete transferohen në të njëjtin nën-program kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve,

4.5 Ministria e Shëndetësisë

4.5.1. €160,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Shërbimi Profesional i Shëndetit Mental të Kosovës, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Ndërtimi i QSHM-Mitrovicë" me kod 13357, këto mjete transferohen në nën-programin Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, kategoria ekonomike shpenzime kapitale për projektin "Ndërtimi i ndërtesës Mitrovice" me kod 11197

4.6 Ministria e Punëve të Brendshme

4.6.1. €365,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga programi Policia e Kosovës, nën-programi Hetimet, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga këto projekte: projekti "Konfidentale - Hetuesi" me kod 13160, në vlerë prej €320,000; projekti "Konfidentcial - DKKO" me kod 30120, në vlerë prej €45,000,

4.6.2. €500,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga programi Policia e Kosovës, nën-programi Shërbimet e Mbështetjes, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Pajisjet policore - Logjistikë" me kod 30041,
4.6.3. €862,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga programi Policia e Kosovës, nën-programi Operacionet Speciale, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga këto projekte: projekti "Armë dhe pajisje speciale për DNJS" me kod 30025, në vlerë prej €462,000; projekti "Autoblinda, Top uji, Limuzina te Blinduara dhe automjete speciale tjera"me kod 12205, në vlerë prej €400,000,
4.6.4. €134,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga programi Policia e Kosovës, nën-programi Policia Kufitare, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale nga projekti "Pajisje të avansura për mbikëqyrje dhe kontroll te kufirit shtetëror" me kod 11150,

4.6.5. E tërë shuma e reduktuar nga nën-programet e lartcekura të Ministrisë së Punëve të Brendshme në shumë prej €1,861,000 transferohet (bartet) në programin - Policia e Kosovës, nën-programin - Shërbimet e Mbështetjes, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.

5. Obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha organizatat buxhetore të ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për lejimin e pagesës së avansit për 30% të vlerës së përgjithshme të Kontratës për "blerjen e librave shkencore për nevojat e Universitetit të Prishtinës" me numër të prokurimit MASHT/12065-115 ku vlera e kontratës është 3,385,324.00 euro.

2. Obligohet Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë që në pajtim me ligjin ta zbatoj këtë vendim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 12/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-069 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Vendoset regjimi i vizave për shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij Vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

2. Shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij vendimi, para se të hyjnë në Republikën e Kosovës, pajisen me viza hyrëse për në Republikën e Kosovës në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

3. Lëshimi i një vize në kufi për shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij vendimi është përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas të cilit viza lëshohet nga misionet diplomatike apo konsullore përgjegjëse.

4. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën I të këtij vendimi, lirohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë hyrëse për në Republikën e Kosovës, në rast se posedojnë vizë të vlefshme shumë-hyrëse *Schengen.* Këta persona mund të qëndrojnë në Republikën e Kosovës për një periudhë prej pesëmbëdhjete (15) ditëve.

5. Regjimi i vizave nuk zbatohet për poseduesit e dokumenteve të udhëtimit të Kombeve të Bashkuara, për të huajt për aq kohë sa statusi i tyre rregullohet me Ligjin nr.03/L-033 për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe konsullore, personelit të tyre, të pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe personelit të tyre në Republikën e Kosovës.

6. Ky vendim nuk paragjykon detyrimet që dalin nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera në lidhje me zbatimin e regjimit të vizave ose vizave për kategori të caktuara.

7. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej tre (3) muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, të harmonizojnë dhe të miratojnë dhe kornizën e nevojshme ligjore për procedurat e lëshimit të vizave për të huaj, në pajtim me legjislacionin e BE dhe *aquis communautaire.*

8. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe fillon së zbatuari nga data 1 korrik 2013.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Shtojca I:**

1. Afganistani;
2. Algjeria;
3. Angola;
4. Armenia;
5. Azerbajxhani;
6. Bangladeshi;
7. Bjellorusia;
8. Bregu i Fildishtë
9. Benini;
10. Bolivia;
11. Burkina Faso;
12. Burundi;
13. Butani;
14. Çadi;
15. Egjipti;
16. Ekuadori;
17. Eritrea;
18. Etiopia;
19. Filipinet;
20. Gaboni;
21. Gambia;
22. Gana;
23. Guinea Ekuatoriale;
24. Guinea;
25. Guinea-Bisau;
26. Gjeorgjia;
27. Haiti
28. India;
29. Indonezia;
30. Iraku;
31. Irani;
32. Jemeni;
33. Kamboxha;
34. Kameruni;
35. Kape Verde;
36. Kazakistani;
37. Kenia;
38. Kirgistani;
39. Kina;
40. Kuba;
41. Laosi (Republika Popullore Demokratike e);
42. Lebanoni;
43. Liberia;
44. Libia;
45. Madagaskari;
46. Majanmari;
47. Mali;
48. Maroku;
49. Mauritania;

50. Moldavia;
51. Mongolia;
52. Mozambiku;
53. Nepali;
54. Nigeri;
55. Nigeria;
56. Pakistani;
57. Peru;
58. Republika Dominikane;
59. Republika Demokratike e Kongos;
60. Republika e Afrikës Qendrore;
61. Republika e Kongos;
62. Republika Popullore Demokratike e Koresë;
63. Ruanda;
64. Rusia;
65. Senegali;
66. Siera Leone;
67. Siria;
68. Somalia;
69. Sudani;
70. Sudani Jugor
71. Surinami;
72. Shri Lanka;
73. Tajlanda;
74. Tanzania;
75. Taxhikistani;
76. Togo;
77. Tunizia;
78. Turkmenistani;
79. Uganda;
80. Ukraina;
81. Unioni i Komoreve;
82. Uzbekistani;
83. Vietnami;
84. Xhamajka;
85. Xhibuti;
86. Zambia;
87. Zimbabve.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 13/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 73 të Ligjit nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për Kryeshefin e Agjencisë për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme në këtë përbërje:

    1.1. Z. Hajredin Kuçi, Zëvendëskryeministër, Kryesues
    1.2. Z. Mahir Yagcilar, Ministër i Administratës Publike, anëtar;
    1.3. Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
    1.4. Z. Demush Shasha, Sekretar i Përgjithshëm në MIE, anëtar dhe
    1.5. Z. Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm në MKRS, anëtar.

2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuar me Ligjin nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës rregulloren nr. 06/2012 për pozita e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera përcjellëse.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

## V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 16,750.00 euro për mbulimin e shpenzimeve për pritjen e z. Ramush Haradinaj dhe bashkëluftëtarëve të tij me rastin e lirimit nga Tribunali i Hagës.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në xhirollogaritë e subjekteve ekonomike pas sjelljes së faturave.

3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/108
Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Koordinatorit Politik për Bisedime në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë z. Blerim Shala i emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, i ndahet një Zyrë brenda ndërtesës së Zyrës së Kryeministrit, gjithashtu për punën e tij do ta ndihmoj edha stafi si në vijim:

    1.1. Shefi i Kabinetit, i cili emërohet nga Koordinatori, paga e të cilit do të jetë e nivelit të këshilltarit politik;

    1.2. Asistenti administrativ dhe një shofer, të cilët kanë status ekuivalent me nëpunësit e kabineteve të ministrave.

    1.3. Paga e koordinatorit është e barabartë me atë të Zëvendësministrit.

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë